



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.05.2023

Nr: 97

Ora: 16:20

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 24, DATË 10.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të bashkisë Cërrik dhe bashkisë Devoll.

BAZË LIGJORE: Nenet 19, pika 1, shkronja “c” dhe 21, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vënie sanksioni ndaj disa personave përgjegjës për raportim të veprimtarive publike, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 24 regj., datë 10.05.2023. Në mbledhjen e datës 11.05.2023, ora 16:20, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali, u konstatua se kërkesa nr. 24 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 24, datë 10.05.2023 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 12.05.2023, ora 13:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar